



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

**Legjislatura III**

---

Komisioni për Punë të Jashtme  
Mbledhja nr. 18  
Prishtinë, më 18. 03. 2009, ora 14:00  
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

**P r o c e s v e r b a l**

**I mbledhjes së Komisionit për Punë të Jashtme**

Në mbledhje morën pjesë: Sabri Hamiti, Enis Kervan, Ramadan Avdiu, Ramë Buja, Lutfi Haziri Ibrahim Gashi, Ardian Gjini dhe Dragisa Miric.

Munguan: Xhavit Haliti, Eqrem Kryeziu dhe Nexhat Daci .

Nga Zyra e Komisioneve të Kuvendit ishin të pranishëm: Minire Hasani dhe Manush Krasniqi.

*Mbledhjen e kryesoi Sabri Hamiti - kryetar i Komisionit.*

**R E N D I I D I T Ë S**

- 1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar;**
- 2. Shqyrtimi i Projektligjit për Protokollin e Shtetit të Republikës së Kosovës;**
- 3. Të ndryshme.**

**1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar**

*Procesverbali i mbledhjes së kaluar u miratua njëzëri.*

**2. Shqyrtimi i Projektligjit për Protokollin e Shtetit të Republikës së Kosovës**

**Sabri Hamiti** - Kjo është mbledhja e tretë me radhë që Komisioni punon në Projektligjin e Protokollit të Republikës së Kosovës.

Për këtë mbledhje Grupi i punës ka propozuar 54 amendamente për t'i shqyrtuar në Komision. Ato janë të paraqitura në tabelën krahasuese me tri shtylla, në të cilat përfshihen teksti i Projektligjit, propozimamendamentet dhe teksti i spastruar i Projektligjit.

Njoftoi deputetët se për Projektligjin nuk është paraqitur ndonjë vërejtje ose propozim nga ndonjë deputet ose komision i Kuvendit.

**Ramadan Avdiu** - Grupi i punës ka bërë përpjekje maksimale për amendamentimin e Projektligjit. Grupi i punës gjatë amendamentimit ka bërë heqjen e disa neneve të përdorimi i simboleve shtetërore, sepse është konstatuar se ato janë bartur nga Ligji për përdorimin e simboleve shtetërore, përcaktimin e rangjeve zyrtare në një nen të veçantë të pozicionuara në rangun e parë, të dytin dhe të tretin.

Janë shtuar edhe dy paragrafë që kanë të bëjnë me unifikimin e rregullave protokollare në të gjitha nivelet, si dhe janë zhvendosur nenet 25 dhe 26 pas nenit 20 të Projektligjit. Amendamentet e tjera, kryesisht, janë riformulime e zëvendësime, sepse nuk ka pasur mundësi të ndryshohet rrënjësisht Projektligji i miratuar në parim.

**Ardian Gjini** - Mendon se Projektligji, edhe pas këtij amendamenti, nuk është i mirë dhe ka nevojë sërish të amendamentohet. Ky projektligj është një pjesë e Rregullores së Protokollit të Shqipërisë. Në Shqipëri protokollit është i rregulluar me rregullore, e jo me ligj për protokollin. Propozoi të kërkohet nga Qeveria ta tërheqë Projektligjin për ripunim, ta hartojë një projektligj të shkurtër, ndërsa çështjet e tjera t'i rregullojë me rregullore.

**Sabri Hamiti** - I respektoj punën e Grupit të punës dhe propozimet e anëtarëve të Komisionit. Meqë Projektligji është miratuar në parim dhe i është proceduar Komisionit për shqyrtim, është detyrë jona t'a amendamentojmë. Propozoj që tekstit të amendamenteve t'i shtohet edhe rekomandimi për redakturë gjuhësore të Projektligjit dhe të bëhet harmonizimi i versioneve gjuhësore.

**Ibrahim Gashi** - Në gjithë botën protokollit ka shumë specifika dhe i rregullon hollësisht çështjet të cilat në momente të caktuara kanë rëndësi të madhe. Këtë projektligj nuk e quaj të mirë, sepse janë munduar t'a përshtatin një ligj të një shteti që atje funksionon mirë. Ai ligj ose është dashur të përgatitej në pajtueshmëri me specifikat tona, ose të merrej i tëri. Mendon se Projektligji duhet të jetë më i shkurtër dhe t'i përmbajë çështjet thelbësore. Për çështje të tjera të funksionimit të protokollit të nxirren rregullore. Propozoi t'i bëhet ftesë Qeverisë për ta rishikuar mundësinë e tërheqjes së Projektligjit nga procedura dhe kjo lëmi të rregullohet me rregullore e jo me ligj.

**Ramë Buja** – E vlerësoi punën e Grupit të punës. Shprehu dyshimin se ky projektligj i amendamentuar mund të bëhet i mirë. Po të lexohet nen për nen, më i lehtë do të ishte rihartimi i Projektligjit, se amendamenti i tij. Nëse kërkohet të miratohet Projektligji urgjentisht mund ta propozojmë për miratim, por nëse nuk është me urgjencë, propozoi të kërkohet kohë për t'u ripunuar.

**Ardian Gjini** - Propozoi të komunikohet me Qeverinë për tërheqjen e Projektligjit për ripunim. Deklaroi se në votimin e amendamenteve do të abstenojë.

**Sabri Hamiti** – Është detyrë e Komisionit ta përfundojë punën e cila i është dhënë nga Kuvendi. Është detyrë e Qeverisë, nëse mendon se duhet të tërhiqet Projektligji dhe detyrë e Kuvendit të vendosë për Projektligjin.

**Komisioni pas diskutimeve dhe votimit nxori këtë**

### ***Përfundim***

*1. Miratohen amendamentet 1, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21, 22, 23, 24, 25, 26, 27, 29, 30, 31, 32, 33, 34, 35, 36, 37, 38, 39, 40, 42, 43, 44, 45, 46, 47, 48, 50, 51, 52, 53, e 54 të Grupit të punës, ndërsa amendamentet 2, 28, 41 dhe 49 miratohen me këto ndryshime:*

*Në amendamentin 2 termi “**fjalinë**” zëvendësohet me “**sintagmën**”,*

*Në amendamentin 28 pas fjalës “**Takimet**” shtohen fjalët e “**nënkryetarëve të Kuvendit**”, ndërsa fjala “**shëfave**” zëvendësohet me fjalën “**kryetarëve**” dhe shtohen fjalët “**kryetarëve të komisioneve kuvendore**”.*

*Në amendamentin 41, grupi II dhe grupi III, riformulohen si vijon:*

**Grupi II: nënkryetarët e Kuvendit, zëvendëskryeministrat, ministrat e Qeverisë, sipas listës së dekretimit, ambasadorët e huaj, ambasadorët e Republikës së Kosovës në detyrë, anëtarët e**

*Gjykatës Kushtetuese, kryetarët e grupeve parlamentare, kryetarët e komisioneve parlamentare, deputetët, kryetari i Gjykatës Supreme, anëtarët e Gjykatës Kushtetuese, kryetari i kryeqytetit, avokati i popullit, kryetari i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, guvernatori i Bankës Qendrore, prokurori i Përgjithshëm i Republikës së Kosovës, komandanti i Përgjithshëm i Forcës së Sigurisë së Kosovës, drejtori i Policisë së Kosovës, drejtori i AIK-së, kryetarët e bashkësive fetare: islame, katolike dhe ortodokse, të ngarkuarit me punë në Republikën e Kosovës, këshilltarët e parë politikë të presidentit dhe të kryeministrit, rektori i Universitetit Publik, ushtarakët me gradën gjeneral, sekretari i përhershëm i Presidencës, i Kuvendit dhe i Zyrës së Kryeministrit dhe këshilltarët e parë të ministrave.*

*Grupi III: kryetarët e komunave, kryesuesit e kuvendeve komunale, sekretarët e përhershëm të ministrave, drejtorët e agjencive dhe të instituteve në nivel vendi, kryetarët e gjykatave të qarkut, prokurorët publikë të qarkut, drejtori i Muzeut, drejtori i Arkivit, kryetari i Organizatës së Veteranëve të Luftës, kryetari i Odës Ekonomike, drejtorët e drejtorive në kuvendet komunale, kryetarët e partive joparlamentare, këshilltarët e kuvendeve komunale dhe drejtuesit e organizatave joqeveritare.*

*Në amendamentin 49, paragrafi 2, pas fjalisë “-Presidenti i Republikës në detyrë” shtohet fjala “ish-presidentët”.*

**2. Rekomandohet që teksti i Projektligjit t'i nënshtrohet redakturës gjuhësore dhe të harmonizohen versionet gjuhësore të Projektligjit.**

*Komisioni, me shumicë votash, i miratoi amendamentet në Projektligjin për Protokollin e shtetit të Republikës së Kosovës.*

### **3. Të ndryshme**

**Sekretari i Kuvendit, z. Ismet Krasniqi** - I njoftoi anëtarët e Komisionit se nga Parlamenti Evropian në Bruksel i është bërë ftesë katër anëtarëve të këtij komisioni dhe dy zyrtarëve për pjesëmarrje në seminarin “Vizat dhe menaxhimi i kufijve”, që do të mbahet më 31 mars dhe 1 prill në Bruksel.

Nisja e delegacionit do të jetë më 30 mars, ndërsa kthimi më 2 prill. Bartës i shpenzimeve do të jetë Kuvendi me mundësi të rimbursimit të shpenzimeve nga PE.

Kërkoji nga Komisioni të propozohen katër deputetë, meqë afati i fundit për ofrimin e emrave të pjesëmarrësve është sot, më 18 mars 2009.

***Komisioni pas diskutimeve nxori këtë***

### ***P ë r f u n d i m***

I rekomandohet Kryesisë së Kuvendit të lejojë pjesëmarrjen e katër deputetëve dhe dy zyrtarëve në seminarin e organizuar nga Parlamenti Evropian në Bruksel më 30 mars deri më 2 prill 2009.

Pjesëmarrës në këtë seminar do të jenë: një deputet nga GP-PDK, Lutfi Haziri nga GP-LDK-së, Ardian Gjini nga GP-AAK-së, një deputet i komuniteteve të tjera, dhe dy zyrtarë të Kuvendit.

Mbledhja përfundoi në orën 15:50.

Kryetari i Komisionit

---

Sabri Hamiti

E përgatiti:

Njësia për Mbështetje të Komisionit